



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 54 Akti

Nr. 52 Vendimi

Tiranë më 30.07.2018

V E N D I M

Trupi gjyqësor i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesues
Valbona Sanxhaktari	Relator
Xhensila Pine	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John LEONARDO, në Tiranë, më datë 27 qershor 2018, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: Z. Shkëlzen Selimi, gjyqtar në Gjykatën Lartë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/ b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike për subjektin, z. Shkëlzen Selimi, ku ai mori pjesë vetëm në fillim të seancës dhe më tej u largua, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërëri,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi, ushtron detyrën e gjyqtarit, në Gjykatën e Lartë dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*. Ai u shortuar si subjekt me përparësi, në shortin e hedhur në datën 30.11.2017, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit” nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit.

2. Relatore e çështjes, u zgjodh me short komisionere Valbona Sanxhaktari. Me vendimin e datës 12.12.2017, trupi gjykues, ka zgjedhur kryesuese për këtë çështje anëtare Etleda Çiftja. Në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ nga relatori i çështjes. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar, z. John Leonardo.

3. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Kualifikuar (DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

3.1 ILDKPKI, pasi ka kryer një procedurë kontrolli për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar duke konkluduar se:

- a. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d. *Nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

3.2 **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe ka dërguar një raport të arsyetuar, duke *konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi.*

3.3 **Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës

objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

4. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga nenin 14, pika 5, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

5. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit, dhe provat e mbledhura, për komponentin e figurës, më datë 04.07.2018, vendosi mbylljen e hetimit kryesisht, vetëm për komponentin e figurës, për subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi dhe kalimin e barrës së provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

6. Subjekti i rivlerësimit u njoftua më datë 06.07.2018 për përfundimin e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës, ju bënë me dije të drejtat që gëzon në bazë të ligjit, mbi të drejtën e tij për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të paraqitura nga Komisioni.

7. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen, por në datën 09.07.2018, kërkoi plotësimin e rezultateve të hetimit me të gjitha faktet dhe provat ku ai mbështetet, duke përfshirë emrat e individëve dhe gjeneralitetet e tyre, si dhe kërkoi kohë shtesë deri në njohjen e plotë dhe efektive me të gjitha provat.

8. Trupi gjykues në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar pranoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit duke i zgjatuar afatin me 3 ditë shtesë.

9. Subjekti i rivlerësimit i drejtohet përsëri në datën 11.7.2018 trupit gjykues me një kërkesë tjetër për zgjatjen e afatit edhe me 5 ditë me qëllim realizimin e një mbrojtjeje të plotë dhe efektive, ndërsa trupi gjykues në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pranon zgjatjen e afatit edhe me 5 ditë, afat i cili shkonte deri në datën 24.07.2018.

10. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegimet dhe provat e tij, brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni. Ai u ftua në seancë dëgjimore, më datë 25.07.2018. Subjekti i rivlerësimit nuk konfirmoi pjesëmarrjen e tij apo të ndonjë përfaqësuesi në seancë dëgjimore.

11. Më datë 26.7.2018 në adresë të Komisionit, në postën elektronike, erdhi një denoncim i cili përmbante informacione lidhur me komponentin e figurës për subjektin e rivlerësimit z. Shkëlzen Selimi. Referuar nenit Ç, pikës 2, të Aneksit të Kushtetutës: "... Këto organe marrin në shqyrtim informacione nga publiku duke respektuar parimin e proporcionalitetit midis privatësisë dhe nevojave të hetimit, si dhe duke garantuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor.", si dhe nenit 49, pika 4, të ligjit nr. 84/2016: "Komisioni dhe Kolegji i Apelitit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indice në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes."

11.1. Duke qenë se, hetimi kryesisht, ishte mbyllur, trupi gjykues nuk e mori në konsideratë këtë denoncim, pasi subjekti i rivlerësimit ishte ftuar në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht faktit se ky denoncim nuk u mor në konsideratë, nëpërmjet postës elektronike u njoftua subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë denoncim.

12. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me përbërjen e trupit gjykues, ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me asnjë nga anëtarët.

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 27.07.2018, ora 11:00, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo.

14. Në këtë seancë dëgjimore subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë. Duke qenë se një ditë para seancës dëgjimore, në televizionin kombëtar "Top Channel", ishin shfaqur publikisht disa informacione lidhur me komponentin e figurës për subjektin e rivlerësimit, ai kërkoi pezullimin e seancës dëgjimore, pasi do ti drejtohej Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe Komisionit të Posaçëm të Apelimit për të filluar një procedurë hetimore, jo ndaj trupit gjykues konkretisht, por ndaj Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 16, pika 2 dhe 10 të ligjit nr. 84/2016, për nxjerrjen e të dhënave konfidenciale, të cilat ishin përdorur dhe mbledhur kundër subjektit të rivlerësimit, duke pretenduar se ky material nuk i ishte vënë në dispozicion as atij vetë.

15. Trupi gjykues u tërhoq në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar për të shqyrtuar kërkesën e subjektit dhe pasi u njoh me të vendosi mos ta pranojë, duke arsyetuar se vazhdimi i kësaj seance dëgjimore nuk pengon të drejtën e tij për të kërkuar hetimi disiplinor sipas kërkesës. Për më tepër që informacioni që subjekti i rivlerësimit i referohej nuk ishte pjesë e hetimit administrativ të zhvilluar për rivlerësimin e tij.

16. Pasi u njoh me vendimin e trupit gjykues, subjekti i rivlerësimit vendosi të mos qëndrojë në seancën dëgjimore, e cila vazhdoi pa prezencën e tij apo ndonjë përfaqësuesi të tij.

III. BASHKËPUNIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT GJATË PROCESIT

17. Subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi, ka dhënë përgjigje lidhur me pyetjet e bëra nga komisioni përgjatë komunikimit elektronik, por në disa raste ai nuk ka qenë i saktë dhe i vërtetë në përgjigje e dhëna.

17.1 Subjekti i rivlerësimit përgjithësisht ka zbatuar afatet e përcaktuara nga Komisioni, ka sjellë shpjegime gjatë procesit të hetimit administrativ dhe ka paraqitur prova dhe shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit.

17.2 Subjekti i rivlerësimit nuk i është përgjigjur të gjitha pyetjeve të bëra në rezultatet e hetimit dhe duke qenë se ai nuk mori pjesë në seancën dëgjimore, trupi gjykues nuk mundi ta pyes subjektin mbi këtë çështje.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT NË LIDHJE ME KOMPONENTIN E FIGURËS

18. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

19. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

19.1 Sipas këtij raporti¹, rezulton se: "...subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në plotësimin e deklaratën për kontrollin e figurës, konkretisht në pikën "ç" të pjesës 5, "Të dhëna për sigurinë", duke mos deklaruar kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, duke e ngarkuar atë me përgjegjësinë e fshehjes së një fakti, si dhe plotësimin e pasaktë dhe me vërtetësi të Deklaratës për Kontrollin e Figurës.

Nga raporti rezulton se për subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi administrohen informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Disponohen të dhëna nga ku ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike.

Në vlerësimi të të dhënave që disponohen, grupi i punës i DSIK-së ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës për subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi."

20. Pavarësisht se sipas KREU V të ligjit "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", DSIK-ja është autoritet përgjegjëse për kontrollin e figurës për subjektet e rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje vlerësimin e figurës së subjektit, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, Komisioni, mund dhe duhet të kryejë një hetim të thelluar.

"41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: "Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit". Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi."

21. Në vijim të procesit të verifikimit të figurës, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë, dhe garantimin e të drejtave të subjektit të rivlerësimit, për një proces të rregullt ligjor, në kuptim edhe të nenit "DH" të Aneksit të Kushtetutës dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017, u krye një hetim i thelluar.

22. Mënyra e kontrollit të figurës, detajohet, brenda parimeve kushtetuese dhe Kreut V të ligjit nr. 84/2016. Gjithë procesi duhet të zhvillohet bazuar në prova të sakta, në mënyrë objektive, që përfshijnë vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në disa lloj konstatimesh.

22.1 Rrethanat mbi të cilat bazohet konstatimi se ekziston një kontakt i papërshtatshëm, sa i përket kontrollit të figurës, përcaktohen në paragrafin 4, të nenit 38, të grupuara në 5 kategori:

- a) Subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;
- b) Subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

¹ Ky raport është deklasifikuar (pjesërisht), më datë 09.05.2018.

- c) *Subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- ç) *Subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- d) *Subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.*

23. Në pikën 2, të nenit “Dh” të Aneksit të Kushtetutës, është përcaktuar se, deklarata e detajuar për figurën, mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit, sipas ligjit.

24. Pavarësisht rezultatit të paraqitura në raportin e DSIK-së se ky subjekt është i papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës, i mbështetur në informacione të marra nga strukturat përgjegjëse për kontrollin e figurës, ato informacione duhen të verifikohen, veçanërisht në lidhje me faktet, nga komisioni. Raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar të tilla që mund ta bëjnë subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tyre.

25. Nga relatori u ndërmorën veprimet e duhura për verifikimin e rezultateve të DSIK-së dhe verifikimin e rrethanave të çështjeve të raportuara nga grupi i punës.

26. Në raport përdorej termi “*Dyshime të arsyeshme*” për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, që do të thotë se është një konkluzion, përfundim apo vlerësim i argumentuar mbi bazën e analizimit të informacionit, të marra nga burime të besueshme dhe me akses.

27. Në raport konstatohej se duke mos deklaruar kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, subjekti i rivlerësimit ngarkohet me përgjegjësinë e fshehjes së një fakti, si dhe plotësimin e pasaktë dhe me vërtetësi të Deklaratës për Kontrollin e Figurës.

27.1 Sipas nenit 38, pika 6, të ligjit nr. 84/2016, “6. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm, në lidhje me një kontakt të papërshtatshëm, janë kur:

- a) *Subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme;*
- b) *Subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt, i cili përforcohet ose konsiderohet i besueshëm nga informacione të shërbimeve të fshehta dhe të besueshme;...*”

28. Në vijim të pikës 3, të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, nenit 50 të ligjit nr. 84/2016, komisioni iu drejtua me kërkesën për informacion të mëtejshëm, të gjitha strukturave përgjegjëse për kontrollin e figurës të përcaktuara në nenin 36 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim garantimin e provave apo krijimin e bindjes së brendshme lidhur me pastërtinë e figurës për subjektin e rivlerësimit.

29. Nga informacioni i mbledhur nga strukturat përgjegjëse ligjzbatuese, gjuha e përdorur dhe afati kohor që i referohej informacioni, u krijua bindja se ato informacione duhet të merreshin në konsideratë dhe të verifikoheshin lidhur me faktet.

30. Gjatë hetimit, nga verifikimi në sistemin *Tims* u ngritën dyshime se subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Selimi, kish udhëtuar jashtë shtetit në më shumë se një rast me një shtetas me inicialet F. D. Gjithashtu në sistemin *Tims* u vërejt se ky shtetas ka pasur në disa raste probleme me drejtësinë (polici, gjykatë, prokurori). Bazuar në këto të dhëna, u konsiderua e nevojshme të verifikoheshin rastet problematike të këtij shtetasi, lidhja e tij me subjektin e rivlerësimit Shkëlzen Selimi, si dhe a është ky shtetas *"Person i përfshirë në krimin e organizuar"* në kuptim të nenit 3, pika 15, të ligjit nr. 84/2016.

"15. "Person i përfshirë në krimin e organizuar" është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë", të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur:

- a) Procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet;*
- b) Deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet."*

31. Për këtë fakt të konstatuar, u pyet edhe subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik a ka ai njohje me këtë shtetas dhe a kanë udhëtuar ata së bashku drejt Gjermanisë dhe Italisë, i cili shpjegoi se:

"...Siç ju shpjegova ne kemi hyrje - dalje familjare të cilën e ruajmë pavarësisht ndryshimit të vendbanimit të familjes sime nga Vlora, prej vitit 2011. Ne takohemi, duke përfshirë: festat familjare, ditëlindjet, përvjetorët, pushime verore, me personin, ose edhe familjarisht. Në disa raste kemi udhëtuar jashtë shtetit të dy, dhe në një rast me familjet, në Gjermani, në dhjetor të vitit 2013."

32. Nga verifikimet e kryera, ka rezultuar gjithashtu se prindërit e këtyre dy shtetasve respektivisht të z. Shkëlzen Selimit dhe F.D., janë përpjekur të kenë së bashku edhe lidhje biznesi. Ky informacion është pranuar edhe nga subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Selimi, përgjatë komunikimit elektronik të datës 13.02.2018.

33. Nga të dhënat e mbledhura nga informacione publike, rezultoi se shtetasi F. D., është ndaluar nga policia e Vlorës në vitin 2011 pasi është gjetur në makinë me armë.

33.1 U kërkua nga prokuroria dhe gjykata e Vlorës dosja e këtij procesi penal. Nga materiali i administruar në atë dosje u konstatua se ky shtetas ishte ndaluar me një makinë me traga të huaja, (e cila rezultonte e vjedhur në një shtet tjetër) dhe më tej u konstatua se ishte në pronësi të shtetasit I. Ç. Makina kishte siguracion në emër të subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi dhe bashkëshortes.

34. Nga hetimi u vërejt se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në pyetësorin e datës 26.12.2017 se ka përdorur këtë makinë, ndërkohë që ka deklaruar për makina të tjera të përdorura nga ai dhe familjarët e tij.

35. Mbështetur mbi materialin e administruar nga dosja penale në ngarkim të shtetasit F. D., u konstatua se shtetasi F. D., ka qenë në shoqërinë e shtetasit E. A., në momentin e arrestimit,

për të cilin ka të dhëna se është në lidhje miqësore dhe interesi me subjektin e rivlerësimit Shkëlzen Selimi.

36. U pyet subjekti i rivlerësimit a kishte dijeni për ngjarjen² dhe ai deklaroi se kishte mësuar për të kohë më vonë, për arsye të miqësisë që këta dy shtetas kishin.

“Kjo ngjarje është mësuar prej meje mbasi ka ndodhur, për shkak të marrëdhënies sime të posaçme (me shtetasin F. D.), siç jua kam shpjeguar në përgjigjen time të datës 13.02.2018.”

37. Duke qenë se u provua njohja dhe lidhja e subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi, me shtetasin F. D., është e nevojshme të provohet nëse ky shtetas është kontakt i papërshtatshëm në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

38. Për këtë arsye iu kërkua informacion, për shtetasin F. D., Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Krimeve të Rënda dhe Ministrisë së Drejtësisë.

38.1 Nga informacionet e mbledhura u konstatua se për shtetasin F.D., figuron të jetë regjistruar procedimi penal nr. *** dhe procedim penal nr. ***.

38.2 Procedimi penal nr. ***, i përket veprës penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe e municioneve” parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal. Në përfundim të këtij procesi ky shtetas është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale të armëmbajtjes pa leje dhe është dënuar me 300.000 lekë gjobë (neni 278/2 Kodit Penal). Kjo është çështja e referuar edhe më lartë dhe është verifikuar dhe analizuar nga komisioni.

38.3 Procedimi penal nr. ***, i përket veprës penale “Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik” parashikuar nga neni 236/1 të Kodit Penal. Ky procedim nuk iu nënshtrua hetimit.

38.4 Po ashtu rezultoi se ndaj shtetasit F. D., Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka filluar procedimin penal nr. *** i vitit 2013, në ngarkim të disa shtetasve shqiptarë si të dyshuar në kryerjen e veprës penale “Trafikim i narkotikëve” kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 183/a parg. II e 22 i Kodit Penal. Ky procedim penal është ende nën hetim, pa një vendim përfundimtar të organit të akuzës.

39. U verifikua nëse ndjekja penale për këtë shtetas është kryer për ndonjë nga veprat penale të parashikuar në neni 75 i Kodit të Procedurës Penale, i cili bën fjalë për veprat penale që ndiqen nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, dhe në referim të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, i referohet personave të përfshirë në krimin e organizuar.

40. Duke e klasifikuar procedim penal nr. *** të vitit 2013, ndaj këtij shtetasi në përputhje me kërkesat e nenit 3, pika 15, të ligjit nr. 84/2016, krijohet bindjen se shtetasi F .D., është një “Person i përfshirë në krimin e organizuar”, e për rrjedhojë edhe një “kontakt i papërshtatshëm” për subjektin e rivlerësimit.

41. Po ashtu konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar, në formularin për vlerësimin e figurës, të plotësuar nga ai, përkatësisht në rubrikën “Të dhëna për sigurinë”, këtë kontakt. Ai ka bërë deklaram të rrem lidhur me kontakte të papërshtatshme me persona të

² Shih komunikimet elektronike me subjektin e rivlerësimit.

përfshirë në krimin e organizuar duket se ai ka fshehur një fakt, si dhe nuk ka plotësuar me vërtetësi Deklaratën për Kontrollin e Figurës.

42. Kontakti i papërshtatshëm i konstatuar është (1) brenda kohës së përcaktuar nga Kushtetuta për deklarimin e kontakteve të papërshtatshme, (2) ai është brenda standardeve të kontrollit të figurës të parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016, pasi u verifikua dhe rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur komunikime jorastësore me personin e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe ata kanë lidhje të ngushta³ mes tyre.

43. Në bazë të pikës 3 dhe 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës:

“3. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të shpjegojë të kundërtën.

4. Nëse subjekti i deklarimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta, ose të fsheh kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të shpjegojë të kundërtën.”

44. Në bazë të nenit 52, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se trupi gjykues ka arritur në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, lidhur me sa janë parashtruar më sipër të cilat ishin pjesë e rezultateve të hetimit.

45. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova dhe shpjegime për trupin gjykues.

45.1 Konkretisht ai shpjegon:

“Parashtroj se ky konkluzion është i gabuar pasi është në kundërshtim me nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës, neni 3, pika 15, të ligjit nr. 84/2016.

Deklarata për Kontrollin e Figurës - shtojca 3 e ligjit nr. 84/2016 është plotësuar prej meje mbi bazën e dijenisë time deri në çastin e plotësimit dhe dorëzimit të saj pranë DSIK-së. Kjo deklaratë është dorëzuar prej meje në janar të vitit 2017. Ndërkohë që emri i shtetasit F. D., në regjistrin e njoftimit të veprave penale është regjistruar nga ana e Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë si person të cilit i atribuohet vepra penale për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 - 22 i Kodit Penal, më datë 19.01.2018, referuar nenit 287/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Fakti që emri i shtetasit F. D., është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale një vit mbas dorëzimit të deklaratës sime për Kontrollin e Figurës provohet nga shkresa “Urdhër, datë 19.01.2018, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, “Për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale”. (provë e re e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit dhe që nuk është marrë në shqyrtim nga trupa gjykuese).

Sikundër provohet lindja e shkakut të papërshtatshmërisë edhe sikur të merret e mirëqenë ka ndodhur pas faktit të plotësimit dhe dorëzimit të Deklaratës për Kontrollin e Figurës pranë DSIK-së. Në të tilla rrethana, nuk kisha sesi të deklaroja një fakt, i cili nuk kishte ndodhur deri në datën e dorëzimit të deklaratës, dhe aq më tepër ta fshihja atë.

³4. Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar,

a) Subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

b) Subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

c) Subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

ç) Subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;

d) Subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës, janë kur:

Pavarësisht se ngjarja kriminale është regjistruar pa autorë, emri i shtetasit F. D., është regjistruar nga Prokuroria për Krime të Rënda në kolonën e personave që i atribuohet vepra penale në datën 19.01.2018, pra rreth një vit pas plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës për kontrollin e figurës nga ana ime.

Pasojat penale për një shtetas fillojnë në momentin kur emri i tij shënohet në regjistrin e njoftimit të veprave penale. Për më tepër këto të dhëna përbëjnë sekret hetimor sipas nenit 278/2 të Kodit të Procedurës Penale⁴, që përbën shkak tjetër të pamundësisë sime objektive, edhe sikur të ishte përpara ditës së dorëzimit të deklaratës për kontrollin e figurës.

F. D., ende nuk është marrë si i pandehur, dhe ende të dhënat për këtë shtetas si subjekt i procedimit penal nr. *** nuk mund të publikohen dhe për efekt të dijenisë vazhdojnë të jenë sekret hetimor.

Për shkaqet ligjore të argumentuara më sipër, si edhe provat bashkëlidhur (Urdhër, datë 19.01.2018 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë "Për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale", Unë, subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Selimi, nuk mund të gjendem në rrethanën e të bërit deklaram të rremë, të fshehjes së një fakti, apo të mosplotësoja me vërtetësi Deklaratën për Kontrollin e Figurës.

Për këtë shkak ligjor dhe të provuar Unë si subjekt i rivlerësimit përjashtohem nga çdo përgjegjësi për deklaram të pavërtetë dhe mospërmendjen e kontakteve të papërshtatshme në Deklaratën për Kontrollin e Figurës – shtojca 3, për sa i përket shtetasit F. D.

Shpjegoj se konkluzioni juaj jo i drejtë ka ardhur si rezultat i informacionit të përcjellë pranë jush nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 12.03.2018. Në këtë shkresë mbi bazën e informacionit të kërkuar nga ana juaj kjo Prokurori ka përmendur vetëm faktin se procedimi penal nr. *** është i vitit 2013, por nuk ka specifikuar se emri i shtetasit F. D., është shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale në datë 19.01.2018. Në këto rrethana dijenia ime objektive, pra të jem në dijeni të këtij fakti penal fillon nga kjo datë, megjithëse edhe kjo e dhënë sipas nenit 287/2 të Kodit të Procedurës Penale është e ruajtur nga sekret i hetimor.

Sikundër e kam shpjeguar edhe gjatë komunikimit elektronik, me shtetasin F. D., kam njohje shoqërore, e cila ka filluar rreth vitit 2005, kur kemi qenë banorë të së njëjtës lagje "***" në qytetin e Vlorës, dhe ka vijuar deri kur unë dhe familja ime jemi transferuar në Tiranë për arsye pune. Pas kësaj kohe, duke filluar nga shtatori i vitit 2011 kontaktet tona janë rralluar, duke u takuar vetëm në rastet e pushimeve apo ditëlindjeve.

Në lidhje me gjetjen nga ana juaj për pasjen e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar shpjegoj se: përveç rastit kur është proceduar për veprën penale të "Mbajtjes pa leje të armëve luftarake", unë nuk kam qenë në dijeni të përfshirjes së shtetasit F. D., në ndonjë vepër tjetër penale as për "Kundërshtim të punonjësit të policisë së rendit publik" dhe as për atë të "Trafikimit të lëndëve narkotike", mbetur në tentativë. Ky fakt nuk më është bërë i ditur as nga shtetasi F. D., dhe as nga organet ligjzbatuese.

Baza ligjore e parashikuar nga ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" parashikon si kusht juridik dhe logjik për deklarimin e kontakteve të papërshtatshme dijeninë e përfshirjes së personit në një vepër penale e parashikuar nga pika "8" dhe pika "15" e nenit 3 të ligjit të sipërcituar, brenda datës 31 janar 2017 të parashikuar në nenit 35 të ligjit nr. 84/2016⁵, ndërkohë që shkak i papërshtatshmërisë për shtetasin F. D., ka ndodhur/lindur në 19 janar të vitit 2018.

⁴Ligji procedural penal në nenin 287 parashikon: "Regjistrimi i njoftimit të veprave penale 1. Prokurori shënon në regjistrë çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. 2. Ndalohet publikimi i regjistrimeve të bëra deri në marrjen si të pandehur të personit që i atribuohet vepra penale."

⁵1.Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaramen për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgon atë pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

Është e vërtetë se unë kam njohje me këtë shtetas, fakt që nuk ua kam fshehur juve si trup gjykues në komunikimin elektronik, por nga ana tjetër unë shpjegoj se në mënyrë absolute nuk kam pasur dijeni të situatave në të cilat shtetasi F. D., të jetë përfshirë. Kjo për faktin se ndaj këtij shtetasi deri në janar të vitit 2018 nuk është zbatuar ndonjë masë policore ose gjyqësore. Nuk ka ndonjë njoftim mediatik apo rrethanë tjetër të cilat të më jepnin indikacione që ky shtetas dyshohej për veprimtari kriminale. Asnjë nga institucionet ligjzbatuese të ngarkuara me ligj për luftën ndaj kriminalitetit (SHISH, Policia e Shtetit, Prokurori) nuk më ka vënë në dijeni për dyshimet në lidhje me aktivitetin kriminal të këtij shtetasi, megjithëse në opinionin tim dhe e theksoj me forcë këtë gjë, ka detyrim të më informojë për çdo kontakt rastësor të papërshtatshëm.

Udhëtimet që kemi bërë me shtetasin F. D., në vitin 2013 unë i kam deklaruar spontanisht pranë trupit gjykues në komunikimet elektronike. Çka tregon se jo vetëm kam thënë të vërtetën, por as nuk kam fshehur dhe as nuk kam pasur qëllim për ta fshehur.

Për më tepër del konkluzioni logjik se në kushtet kur nga Policia Kufitare ky shtetas nuk është penguar për të lëvizur jashtë shtetit, as ai vetë nuk ka qenë në dijeni të problemeve me ligjin, prandaj nuk kishte sesi të më tregonte kur as ai vetë nuk kishte dijeni për papërshtatshmërinë. Fakti që nuk kam qenë në dijeni provohet edhe për arsye që siç e pohoni edhe ju në "Rezultatet e hetimit për Komponentin e Vlerësimit të Figurës" procedimi penal është në hetim që prej vitit 2013, pa një vendim përfundimtar të organit të akuzës. Çka do të thotë se përbën sekret hetimor dhe nuk kisha mundësi objektive se si të merrja dijeni, kur konsiderohet për vetë organet e shtetit.

E nderuar Trupë Gjyqësore,

Jo vetëm në Deklaratën për Kontrollin e Figurës, por edhe në komunikimin elektronik në lidhje me pyetjet që më keni drejtuar për këtë shtetas unë kam qenë i sinqertë, bashkëpunues dhe nuk kam fshehur asnjë fakt për aq sa kam pasur dijeni.

Sqaroj se dijenia ime për problemet me ligjin të këtij shtetasit ka qenë e kufizuar vetëm në rastin e dënimit të tij për veprën penale të "Mbajtje pa leje të armëve luftarake", fakt i cili ka ndodhur kur unë isha larguar dhe nuk jetoja më në qytetin e Vlorës, duke rralluar natyrshëm kontaktet dhe dijeninë time se çfarë bënte ai në jetën e përditshme.

Ndërsa për çdo problem tjetër me ligjin për këtë shtetas unë kam marrë dijeni vetëm në momentin e tërheqjes së dokumenteve pranë Institucionit tuaj. (shih komunikimin elektronik të datës 14.02.2018)

Ka disa rrethana objektive që mbështesin pretendimet e mia: i) pas emërimit tim në Gjykatën e Lartë në qershor të vitit 2011, unë dhe familja ime jemi shpërngulur nga qyteti i Vlorës dhe jetojmë në qytetin e Tiranës, në një distancë prej 150 km; ii) lidhja shoqërore nga viti në vit është dobësuar dhe kontaktet janë rralluar, duke mbetur vetëm në raste festa familjare apo pushime; iii) pas vitit 2013, siç e konstatojmë nga të dhënat e sistemit TIMS nuk ka asnjë udhëtim familjar apo personal me këtë shtetas.

Nga ana juaj në faqen 5 të "Rezultateve të hetimit", është paraqitur si gjetje edhe "Mosdeklarimi i përdorimit të automjetit me targë *** në pronësi të shtetasit I.Ç., në të cilën është arrestuar në flagrancë shtetasi F.D., si edhe lidhja miqësore dhe interesi me shtetasin E.A."

Në lidhje me këtë gjetje dua të sqaroj se mosdeklarimi i faktit të përdorimit të automjetit, ka ardhur për shkak se nuk kemi të bëjmë me përdorim të një sendi si e drejtë reale në kuptimin civil, por me përdorje/mbajtje të përkohshme për shkak të një nevojë momentale të atëhershme, të paqëndrueshme në kohe dhe jo në kontakt të drejtpërdrejtë me automjetin.

Siç e kam deklaruar si mjet transporti për plotësimin e nevojave të familjes sime, nga tetori i vitit 2003 deri në 09.07.2011, unë kam përdorur automjetin tip "Fiat" me targë ***, pronë e bashkëshortes sime (e deklaruar edhe në deklaratën periodike të vitit 2011, ashtu edhe në Deklaratën - Vetting). Ky automjet është shitur prej saj në datën 09.07.2011, ndërkohë që automjeti tjetër tip "Mercedes Benz" me targë *** është blerë prej nesh më datë 26.07.2011,

pra unë për një periudhë 2 - javore kam qenë pa automjet. Për më tepër në këtë kohë unë po bëja edhe transferimin e familjes sime drejt Tiranës, meqenëse isha emëruar anëtar i Gjykatës së Lartë.

Mbajtja e përkohshme e automjetit lindi si nevojë e ngutshme për transportin e familjes dhe sendeve personale. Në këto rrethana iu drejtova të njohurit tim I. Ç (për të cilin kam bërë shpjegime, shih komunikimin elektronik datë 21.02.2018) për ndihmë. Pra automjeti në pronësi të shtetasit I. Ç., është përdorur vetëm për dy javë. Polica e sigurimit sipas rregullave të parashikuara në Dekretin, nr. 295, datë 15.9.1992, "Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë" mund të pritet për një afat të plotë vlefshmërie 1 vjeçar, dhe jo të përkohshëm 1 javor ose 1 mujor.

*Siç provohet nga përmbajtja e policës së sigurimit periudha e sigurimit fillon, pikërisht, kur unë nuk kisha mjet transporti dhe pavarësisht kohëzgjatjes formale të saj e detyrueshme sipas ligjit. Makina është përdorur vetëm për disa raste të transportit familjar nga Vlora në Tiranë dhe anasjelltas. Më datë 09.07.2011 me blerjen e automjetit me targë ***, ka përfunduar si nevoja ime, ashtu dhe mbajtja e përkohshme e automjetit të shtetasit I. Ç. Si ky automjet edhe në disa raste të tjera figurojnë polica sigurimi në emrin tim edhe për automjete të tjera, por që nuk hyjnë në kategorinë e përdorimit të mjetit, por mbajtjes së përkohshme të një sendi.*

Ndërsa për sa i përket miqësisë dhe interesit me shtetasin E. A., deklaroj me përgjegjësi të plotë se e njoh si qytetar të Vlorës, por nuk kam asnjë lidhje miqësie dhe aq më tepër marrëdhënie biznesi apo interesi me të.

Përfshirja e një personi në një nga veprimtaritë kriminale parashikuara nga pika "8" dhe pika "15" e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" do të thotë se ligji kërkon: i) dijeninë e subjektit të rivlerësimit, jo vetëm për kontaktin që realizon, në këtë rast është njohja shoqërore; ii) por edhe të dijenisë së shkakut të papërshtatshmërisë, pra përfshirjen e personit në një veprimtaritë kriminale të parashikuara në mënyrë ezauruese nga ligji."

45.2 Subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues të administrojë provat plotësuese si pjesë e dokumentacionit:

1. Urdhër datë 19.01.2018, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë "Për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale".
2. Karakteristikë datë 10.07.2018, për "Familjen e F. D.", Bashkia Vlorë, rajoni nr. ***.
3. Çertifikatë familjare datë 09.07.2018.
4. Vërtetim datë 11.07.2018, i Universitetit "****", Vlorë.
5. Çertifikatë regjistrimi, pranë QKB-së personit të tatuështëm F. D.
6. Vërtetim datë 10.07.2018, i Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë për shtetasin M. D.

46. Trupi gjykues vlerësoi sqarimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit si dhe provat bashkëlidhur të paraqitura prej tij dhe konstaton se:

47. Urdhri i datës 19.01.2018 i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë "Për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale", i paraqitur si prove e re nga subjekti, qëndron.

47.1 Nga informacioni i ardhur nga Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë rezulton se më datë 16.11.2013 mbi bazën e një informacioni referues të Departamentit kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit është regjistruar procedimi penal me nr. **, Fakti penal për të cilin po hetohej lidhej me veprimtarinë e kryer në bashkëpunim nga disa persona, për

trafikimin e lëndëve narkotike. Nga hetimet e zhvilluara janë evidentuar tre episode në të cilat është gjetur dhe sekuestruar sasi e konsiderueshme lëndë narkotike.

47.2 Procedimi penal me nr. *** i vitit 2013, është një procedim i ndjekur me hetime proaktive, që nënkupton faktin se ka pasur disa subjekte të dyshuara si të përfshira në veprimtarinë e trafikimit të lëndëve narkotike, një ndër të cilët është dhe shtetasi F. D. Në këtë mënyrë lidhja e shtetasit F. D., me këtë çështje fillon që në momentin e parë të regjistrimit të procedimit penal, jo si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet por si person për të cilin ka dyshime që është i përfshirë në veprimtari. Ky shtetas është referuar nga organet e policisë si person i dyshuar për përfshirjen e tij në trafikimin e lëndëve narkotike që në vitin 2013, sipas informacionit për referimin e veprës penale në prokurori të datës 14.11.2013.

47.3 Një pjesë e subjekteve të hetuara në funksion të procedimit penal me nr. *** janë dërguar për gjykim dhe janë dënuar me vendim të formës së prerë. Ndërkohë ka vijuar hetimi për subjekte të tjera për të cilat është bërë e mundur të sigurohen nga veprimet hetimore të kryera dyshime të arsyeshme të bazuara në prova si të përfshirë në veprimtarinë e trafikimit të lëndës narkotike. Pas administrimit të letërporosisë nga autoritetet italiane të drejtësisë dhe kryerjes së veprimeve të tjera hetimore, më datë 19.01.2018, është regjistruar në regjistrin e njoftimit të veprave penale, në kolonën përkatëse për procedimin penal nr. ***, të vitit 2013 si i hetuar, edhe shtetasi F.D.

48. Rezulton se shtetasi F. D., është një person i përfshirë në krimin e organizuar në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Vetë ligji ka parashikuar se person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar apo proceduar penalisht. Njohja, lidhur me faktin e procedimit penal, është subjektive. Shtetasi F. D., rezulton një person i përfshirë në krimin e organizuar dhe për pasojë ai është një kontakt i papërshtatshëm, për subjektin e rivlerësimit Shkëlzen Selimi.

49. Lidhur me mosdeklarimin e këtij kontakti të papërshtatshëm, përkatësisht në rubrikën “Të dhëna për sigurinë”, nga subjekti i rivlerësimit, referuar pikës 4, të nenit Dh, të Aneksit të Kushtetutës, vlerësojmë se sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me datën e regjistrimit të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, qëndrojnë duke e rrëzuar këtë rezultat të hetimit.

50. Objekti i kontrollit të figurës, për subjektet e rivlerësimit, është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe i të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin “DH” të Aneksit të Kushtetutës. Kontrolli i figurës nuk limitohet vetëm tek deklarimi i kontakteve të mundshme, por në thelb ka për qëllim konstatimin nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të tilla të papërshtatshme.

51. Nga komunikimet elektronike me subjektin e rivlerësimit dhe shpjegimet e bëra prej tij lidhur me barrën e provës, arrihet në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të shpeshta me shtetasin F. D., edhe pasi ai është larguar nga qyteti i Vlorës dhe se kontaktet nuk kanë qenë rastësore. Shtetasi F. D., është sot një person i përfshirë në krimin e organizuar. Ai vazhdimisht ka qenë person me probleme për drejtësinë. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar njohjen me këtë shtetas vetëm pas pyetjeve direkte të komisionit. Në disa nga sqarimet e tij subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi informacion e kërkuar.

52. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, lidhur me njohjen me shtetasin F. D., si një kontakt i papërshtatshëm, nuk arritën të rrëzojnë gjetjen e konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

53. Shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me njohjen e tij, me shtetasin E. A., e cila rezultoi nga hetimi dhe për të cilën u ngritën dyshime për lidhje jorastësore me subjektin e rivlerësimit, nuk arritën të rrëzonin gjetjen e konstatuar, dhe të bindin trupin gjykuese, pasi rezultoi e provuar se ata kanë pasur komunikime telefonike jo rastësore së bashku dhe në mënyrë të vazhduar.

54. Gjatë hetimit, rezultuan gjithashtu edhe kontakte të tjera të subjektit të rivlerësimit me persona të dyshuar si kontakte të papërshtatshëm.

55. Nga informacione të mbledhura gjatë hetimit rezultoi se subjekti i rivlerësimit kishte lidhje të ngushta miqësore me shtetasin I. Ç. Nga verifikimi rezultonte se ky shtetas ishte i skeduar nga policia. Ai figuron i regjistruar në vitin 1996 si person me precedent kriminal. Në vitin 2015, ai merret në procedim policor për tendencë vrasjeje⁶.

56. Iu kërkua subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegime për njohjen që ai ka me shtetasin I. Ç., si dhe lidhjet me të.

56.1 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi:

"Pavarësisht se nuk kam barrë prove për këtë shtetas, por jam ftuar të jap shpjegime, ashtu siç kam deklaruar në komunikimin elektronik shtetasin I. Ç., e njoh që prej vitit 2007. Marrëdhënia shoqërore e krijuar me këtë shtetas nuk ka ardhur për shkak të detyrës, pasi unë në cilësinë e gjyqtarit të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe këtë e deklaroj me përgjegjësi të plotë nuk kam gjykuar ndonjë çështje personale të karakterit civil ose penal.

*Njohja ime me të e ka zanafillën rreth vitit 2007 për shkak të rrethanave rastësore. Shtëpia ku banon ky shtetas ndodhet në pjesën historike dhe turistike të qytetit të Vlorës, gjithashtu afër pallatit ku unë kam banuar. Gjatë kohës së lirë në përkujdesjen e tre fëmijëve të mi, në atë kohë fare të mitur, si vend argëtimi për fëmijët ka qenë "****" dhe pjesa e gjelbëruar pranë "****", pikërisht vendi ku ndodhet banesa dhe lokali i shtetasit I.Ç.*

Më ka tërhequr vëmendjen që në fillim se në murin rrethues të shtëpisë një-katëshe dhe lokalit ka të vendosur një pllakatë në të cilën shkruhet se "Shtëpia e Ilmi Nepravishtës ka qenë bazë e Luftës Nacionaleçlirimtare". (Për referencë libri i Gjeneral Rrahman Parllakut, Hero i Popullit). Kam asistuar vetë dhe kam qenë prezent kur autoritetet më të larta lokale dhe deputetët e zonës kanë ardhur për vizitë në shtëpinë dhe lokalin e tij në rastin e Ditës së Dëshmorëve apo për Festat e 28 - 29 Nëntorit.

Ky shtetas bën një jetë të rregullt familjare dhe jeton mbi bazën e vetë-punësimit në një lokal pranë shtëpisë së tij. Bashkëshortja e tij ka punuar pranë Zyrës Vendore të Avokaturës së Shtetit, Vlorë dhe aktualisht punon pranë administratës së Universitetit të Vlorës.

*Shtetasi I. Ç., ka përfunduar studimet e larta për drejtësi në universitetin jopublik "****", Vlorë. Në jetën publike ai është shfaqur gjithmonë si qytetar i rregullt dhe nga viti 2007, kur unë e njoh ai nuk ka pasur asnjë përfshirje në ngjarje kriminale publike të çfarëdolloj shkalle rrezikshmërie.*

Në lidhje me informacionin policor që ju dispononi për këtë shtetas unë nuk jam në dijeni me përmbajtjen e tij, pasi as nga autoritetet përkatëse dhe as nga ana juaj nuk është vënë në dispozicion apo nuk më është kërkuar shpjegim. Fakti që nuk ka një përcjellje të këtyre të dhënave pranë organit të akuzës për ushtrimin e ndjekjes penale tregon se ato kanë qenë të

⁶ Të dhëna të nxjerra nga sistemi Tims.

pambështetura. Në jetën e përditshme çdokush në ndonjë rast mund të jetë, qoftë edhe rastësisht prezent ose "i dyshuar nga policia" në një ngjarje kriminale. Është detyrë e policisë që për çdo rast të verifikojë dhe të sqarojë e zbulojë rrethanat përkatëse. Ligji vepron mbi të gjithë, liritë dhe të drejtat janë të garantuara, për më tepër kur bëhet fjalë për sqarimin e rrethanave që përbëjnë shkeljen e të drejtave të të tjerëve.

Për sa i përket skedimeve policore nuk më është vënë në dijeni përmbajtja e tyre, çka më vë në pamundësi për t'u shprehur në lidhje me vërtetësinë dhe rëndësinë juridike të tyre. Për më tepër pas kërkesës që unë i bëra shtetasit I. Ç., ai iu drejtua organeve policore për të marrë informacion në lidhje me këto fakte të pretenduara prej jush dhe përgjigja nga Drejtoria e Policisë, Qarku Vlorë, ishte negative (Kërkesa datë 13.0.2018, drejtuar Komisarariatit të Policisë Vlorë). Ky organ policor pavarësisht detyrimit ligjor që ka në bazë të ligjit "Për të drejtën e informimit", nuk ka kthyer një përgjigje.

Pra si mund të jem unë në dijeni të një fakti për një person tjetër, kur fakt i mbahet i fshehtë dhe vetë personit të interesuar, dhe asnjë organ ligjzbatues nuk më ka vënë në dijeni të për ndonjë "papërshatshmëri" në këtë marrëdhënie shoqërore që kam me shtetasin I. Ç.

Për shkak të përgatitjes së shpjegimeve dhe argumenteve lidhur me rezultatet e hetimit paraprak, unë pyeta shtetasin I. Ç., i cili më deklaroi se: "nuk ka pasur probleme me autoritet gjyqësore/hetimore/policore dhe nuk është përfshirë në asnjë veprimtari kriminale", siç pretendohet nga ana juaj. Në bazë të kërkesës sime nga ana e këtij shtetasi mu vunë në dispozicion këto prova, që mbështesin shpjegimet e mia në lidhje me njohjen me këtë shtetas, situatën shoqërore dhe juridike të tij."

56.2 Subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues të administrojë provat plotësuese si pjesë e dokumentacionit.

1. Karakteristikë datë 10.07.2018, për z. I. Ç., Bashkia Vlorë, Rajoni nr. ***.
2. Vërtetim nr. *** prot., datë 09.07.2018, nga av. K. D.
3. Certifikatë regjistrimi, pranë QKB-së personit të tatueshëm I. Ç.
4. Vërtetim nr. *** prot., datë 12.07.2018, i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
5. Fotografji të murit të jashtëm të banesës së shtetasit I. Ç.
6. Vërtetim nr. *** prot., datë 16.07.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.
7. Kërkesë për informacion datë 13.07.2018, drejtuar Komisarariatit të Policisë Vlorë.

57. Trupi gjykues vlerësoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, por vlerësoi se ai nuk solli ndonjë provë që të rrëzojë gjetjet e hetimit administrativ.

58. Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta dhe miqësore me shtetasin A. D. Ky shtetas dyshohet se ka pasur kontakte me persona të përfshirë në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike, përfshirë edhe përfaqësimin si avokat mbrojtës në disa çështje gjyqësore në ngarkim të tyre. Po ashtu ky shtetas dyshohet edhe se mund të ketë qenë i dënuar në një shtet tjetër për veprimtari të kundërligjshëm. Në vitin 2015 ky shtetas është shpallur në kërkim policor nga DVP Vlorë për veprën penale "Mashttrim", për të cilën vazhdon hetimi nën masën e sigurisë "Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore"⁷.

59. Në mbështetje të rezultateve të hetimit është krijuar dyshimi se ky shtetas ka lidhje të ngushta me subjektin e rivlerësimit, si dhe lidhje të mundshme biznesi apo veprimtari të tjera fitimprurëse.

60. Për më tepër nga hetimi rezultoi se, më datë 15.06.2017, shtetasi K. S (babai i gjyqtarit) ka blerë me kontratën e shitblerjes me rezervë pronësie një truall për pikë karburantit, në qytetin

⁷ E dhënë e marr nga sistemi tims.

e Vlorës nga shtetasi A. D., dhe gruaja e tij. Nga hetimi rezultoi se ka pasur një përpjekje që kontrata të ishte në bashkëpronësi me babain e shtetasit F. D., të përmendur më sipër, por që nuk ka rezultuar e suksesshme.

60.1 Gjithashtu subjekti i rivlerësimit, ka deklaruar më datën 21.02.2018, pas pyetësorit të dërguar nga ne se: *“Nga ana ime nuk u pa me vend përfshirja në këtë blerje, për shkak se edhe sot e kësaj dite unë nuk kam në pronësi një apartament banimi dhe objektivi primar i familjes sime është blerja e një apartamenti banimi.”*

61. Subjekti i rivlerësimit, gjatë komunikimit nëpërmjet postës elektronike të datës 21.02.2018, ka pranuar miqësinë me këtë shtetas, por ka deklaruar se nuk ka ndonjë marrëdhënie interesi apo biznesi me këtë shtetas.

62. Si pjesë e rezultateve të hetimit administrativ iu kërkua që subjektit të rivlerësimit të jepte shpjegime për njohjen që ai ka me shtetasin A. D., si dhe lidhjet me të.

62.1 Subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto sqarime:

“Pavarësisht se nuk kam barrë prove për këtë shtetas, por jam ftuar të jap shpjegime, sikundër kam deklaruar në komunikimin elektronik datë 21.02.2018 e njoh gjatë kohës që unë kam ushtruar detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Deklaroj me përgjegjësi të plotë se nuk kam pasur dhe as nuk kam marrëdhënie shoqërore me këtë shtetas. Vërej se relacioni ka disa pasaktësi lidhur me: i) paraqitjen e lidhjes midis meje dhe shtetasit A .D. ii) marrëdhënies juridiko-civile si dhe iii) marrëdhënies së interesit, të cituara prej jush në rezultatet e hetimit.

Konkretisht në pyetjen e dërguar prej jush, më datë 21.02.2018 - cila është marrëdhënia ime me shtetasin A. D. - Unë kam shpjeguar se: “...Shtetasi A. D., është i njohur prej meje fillimisht si gazetar lokal, dhe më pas ka ushtruar profesionin e avokatit gjatë periudhës që unë kam qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Unë dhe bashkëshortja ime kemi pasur në pronësi një automjet tip “Mercedes-Benz”, i cili i është shitur me kontratën, datë 02.08.2012, shtetasve A.D., dhe E. D. Ky veprim është deklaruar prej meje dhe bashkëshortes sime në deklarinë e pasurisë që i përket vitit 2012 si dhe në deklaratën për procesin e rivlerësimit. Përveç këtij veprimi unë personalisht nuk kam ndonjë marrëdhënie interesi të mëtejshëm me këtë shtetas...”

Siç shikoni nga përmbajtja e komunikimit elektronik me ju, në përgjigje unë kam folur për marrëdhënie profesionale dhe jo miqësore me këtë shtetas. Gjithashtu kam pranuar një marrëdhënie juridiko-civile duke dhënë shpjegime të rrethanave dhe objektit konkret të saj.

Pra, ndryshe nga sa parashtrohet në rezultatet e hetimit, unë nuk kam blerë automjet nga shtetasi A.D., por i kam shitur atij automjetin tip Mercedes Benz, gjithashtu deklarimi im fillestar për këtë kontratë nuk është bërë në deklaratën e kontrollit të pasurisë për efekt të rivlerësimit, por në deklarinë periodik të vitit 2012, kohë në të cilën është kryer ky veprim.

Kërkoj që këto rrethana fakti të provuara të ndreqen prej jush dhe të pasqyrohen saktësisht në rezultatet e hetimit që do prezantohen në seancë publike.

Gjithashtu pagesa e blerjes nga shtetasi A.D., është kryer nëpërmjet bankës (shiko mandatpagesën shoqëruar kontratës), si një veprim krejtësisht transparent.

Këto dy rrethana i) shitja dhe jo blerja nga ana ime; ii) pagesa nëpërmjet sistemit të kontrolluar bankar, përjashtojnë çdo lloj mundësie për ekzistencën e interesave të fshehta, ose konfliktit të interesit.

Mund ta verifikoni nga regjistrat gjyqësorë civilë se edhe përpara se të kryhej ky veprim juridik - civil, nuk kam gjykuar çështje private të këtij shtetasi në Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë. Edhe çështjet në të cilat ai ka përfaqësuar palë private kanë qenë të një rëndësie të vogël ku sipas verifikimeve të mia, dhe gjithashtu të kryera prej jush për pjesën civile janë çështje pa

interesa pasurore, ndërsa për çështjet penale vendimmarrja nuk ka qenë në asnjë rast në favor të klientit të përfaqësuar nga ky avokat.

Pas shitjes dhe dorëzimit të automjetit komform ligjit, unë nuk kam pasur dhe nuk kam më asnjë lloj marrëdhënie interesi, as edhe kontakt me këtë shtetas.

Për sa i përket konstatimit tuaj në lidhje me një veprim juridik civil të kryer/kontratë shitje-trualli me rezervë pronësie, e lidhur midis babait tim K. S dhe shtetasit A. D., këtë fakt e kam konfirmuar në komunikimin elektronik datë 21.02.2018. Dua të shtoj se ky veprim është kryer sipas ligjit financiar, ka dhënë pasojat civile dhe pas kësaj nuk ka asnjë marrëdhënie tjetër interesi midis tyre.

Gjithashtu më lejoni të komentoj mbi konstatimin tuaj se: "shtetasi A. D. rezulton si shtetas me kontakte te papërshtatshme, me persona të përfshirë në trafikun ndërkombëtar të lëndëve narkotike, duke i përfaqësuar ata si avokat mbrojtës në disa çështje gjyqësore në ngarkim të tyre".

Shtetasi A. D., për shkak të ushtrimit të funksionit të tij si avokat ka kontakte me persona të cilët hetohen dhe dënohen, kur kjo lidhje është në ushtrim/përmbushje të detyrës së tij, sipas ligjit nuk duhet të konsiderohet si e papërshtatshme. Njëkohësisht nuk kam dijeni në lidhje me ndonjë veprimtari të tij të kundërligjshme.

Papërshtatshmëria për efekt të detyrës është absolutisht e përjashtuar nga neni 28/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji për Avokatinë.

Për shkak të përgatitjes së parashtrimeve mbi rezultatet e hetimit paraprak, unë vendosa kontakte me këtë shtetas dhe në bazë të informacionit më deklaroi se nuk ka pasur probleme me autoritetet gjyqësore të huaja, ashtu siç dyshohet prej jush, ndërsa për çështjen e masës së sigurimit që ju i referoheni dhe problematika të tjera të dala gjatë ushtrimit të detyrës, si konflikte me palë, apo klientë nuk ka asnjë vendim penal dënimi. Rasti konkret që ju si trup gjykues keni konstatuar ndaj shtetasit A. D., për masën e sigurimit të përmendur në rezultatet e hetimit nuk përfshihet në kategorinë e atyre të parashikuara nga pika "8" dhe pika "15" e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, si kontakt i papërshtatshëm.

*Gjithsesi me vendimin nr. ***, datë 17.05.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë është miratuar vendimi i pushimit të prokurorit pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për çështjen e masës së sigurimit që ju i referoheni.*

Pas kërkesës sime nga ana e tij mu vunë në dispozicion këto prova, të cilat mbështesin shpjegimet e mia."

62.2 Subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues të administrojë provat plotësuese si pjesë e dokumentacionit:

1. Vendim, "Për pushimin e çështjes penale", datë 22.10.2015.
2. Vendim nr. ***, datë 17.05.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

63. Trupi gjykues vlerësoi shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe konstatoi se shpjegimet e tij ishin bindëse lidhur me dyshimet e ngritura për këtë shtetas se është shpallur në kërkim policor nga DVP Vlorë për veprën penale "Mashttrim", për të cilën vazhdon hetimi nën masën e sigurisë "Detyrim paraqitje në policinë gjyqësore". Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit mbi dyshimet për lidhje të ngushta me këtë shtetas, si dhe lidhje të mundshme biznesi apo veprimtari të tjera fitimprurëse, nuk arritën të rrëzonin dyshimet e ngritura.

64. Gjithashtu, si pjesë e hetimit të thelluar, është kërkuar informacion në lidhje me ndonjë procedim penal ndaj subjektit të rivlerësimit Shkëlzen Selimi, apo përfshirjes së tij në ndonjë proces hetimor.

64.1 Në përgjigjet e dërguara nga Prokuroria e Përgjithshme, rezulton që ndaj subjektit të rivlerësimit kanë qenë 3 kallëzime penale të cilat kanë përfunduar me vendim mosfillimi.

65. Trupi gjykues administroi gjetjen⁸ e paraqitur në formën e një deklarate nga vëzhguesi ndërkombëtar, komform nenit 49, pika 10, të ligjit nr. 84/2016.

66. Sipas informacionit të paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar bëhej fjalë për përfshirjen e subjektit të rivlerësimit në veprime të kundërligjshëm, shfaqur në formën e ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike.

66.1 Konkretisht ajo citon:

"Në bazë të informacionit të siguruar nga burime të besueshme konfidenciale të qeverive të huaja, Vëzhguesit Ndërkombëtarë kanë ofruar këtë gjetje në bazë të nenit 49.5 dhe nenit 49.10. të ligjit nr. 84/2016:

*Ka prova që tregojnë qartë se subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi, është përfshirë në kontakte të papërshtatshme (neni 38.4 i ligjit nr. 84/2016) të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta, me një person, për llogari të shtetasit A. I., gjithashtu i njohur me nik name *** i cili ishte i përfshirë në krimin e organizuar (siç përcaktohet në nenin 3.15. të ligjit nr. 84/2016). Në gjysmën e parë të vitit 2015, gjyqtari Selimi ka tentuar të ndërhyjë për llogari të shtetasit A. I., në mënyrë që të ndikonte rezultatin e çështjes në shqyrtim të tij përpara gjykatës shqiptare, mbi ekstradimin e tij në një shtet fqinj, për tu përballur me akuzat penale. Si rezultat i mundshëm i kësaj ndërhyrje nga ana e gjyqtarit Selimi, në korrik 2015 kërkesa për ekstradimin e shtetasit A. I., në shtetin fqinj u rrëzua dhe ai u la i lirë."*

67. Kjo gjetje e paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë apo standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur, referuar pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016 dhe konsiderohet e besueshme dhe mjaftueshëm konsistonte me provat e tjera të cilat trupi gjykues i konsideron si indice të vlerësimit në tërësi.

Gjetja shoqërohej me një informacion konfidencial, i cili nuk mund të bëhet publik, pasi ishte një kusht i vënë nga qeveria e huaj⁹ dhe që mund të rrezikonte burimin.

68. U administruan të gjitha dosjet e procesit të ekstradimit të shtetasit A. I., për të cilën bën fjalë edhe gjetja e ndërkombëtarit. Nga verifikimi i dosjeve në tërësi për të gjithë këtë proces u krijua bindja se subjekti i rivlerësimit Shkëlzen Selimi, ka realizuar me sukses ndikimin e tij në këtë çështje. Bindja u krijua mbështetur në informacionin e administruar në dosje dhe informacionin shoqëruar "konfidencial" të ardhur për këtë çështje nga qeveria e huaj.

69. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu ka qenë edhe pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar kërkesën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, për vazhdimin e masës së sigurisë arrest me burg kundër shtetasit A. I., më datë 02.07.2014.

70. Po ashtu nga një informacion që erdhi nga Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit, (vendimi i një gjykate të huaj) konstatohet se ndaj shtetasit A. I., ka një procedim penal në shtetin Italian "për pjesëmarrje në organizatë kriminale dhe trafikim ndërkombëtar të lëndëve

⁸ 10. Gjetja e paraqitur në formën e një deklarate, dokumenti ose raporti të dhënë nga vëzhguesi ndërkombëtar, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë ose standard ligjor, i cili ekziston ose ka ndodhur. Gjetja parashtron rrethanat për konstatimin e bërë. Komisioni ose Kolegji i Apelitit e çmon gjetjen si të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert. Refuzimi i gjetjes bëhet me vendim të arsyetuar të Komisionit ose të Kolegjit të Apelitit.

⁹ Neni 39.2 e ligjit nr. 84/2016

narkotike, të llojit kokainë”. Ky fakt e bën këtë shtetas “Person të përfshirë në krimin e organizuar”.

71. U krijua bindja se subjekti i rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi, ka njohje me shtetasin A. I., (kontakte jorastësore) i njohur publikisht si person i përfshirë në krimin e organizuar por edhe i provuar si i tillë. Duket se ai ka ndihmuar këtë shtetas duke u përfshirë në veprime të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës si dhe ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrjnë funksione publike.

72. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar shtetasin A. I., si kontakt të papërshtatshëm dhe as njohjen me të.

73. Nga verifikimi i policave të sigurimit rezultoi gjithashtu se subjekti i rivlerësimit ka përdorur në vitin 2010 - 2011 dhe 2011 - 2012 makinën me targa *** e cila sipas burimeve të policisë së shtetit figuronte në emër të shtetasit A. Sh (i dënuar për kundërshtim të forcave të rendit publik) dhe i njohur botërisht si shoferi i shtetasit A. I.

73.1 Subjekti i rivlerësimit ka pranuar përgjatë komunikimeve elektronike se ka përdorur këtë makinë dhe se e njëj këtë person, por në pyetësorin e dërguar në fillim të procesit të rivlerësimit (datë 23.12.2017) ai nuk e ka deklaruar këtë fakt. Ai e ka pranuar vetëm pasi ne e kemi pyetur lidhur me konstatimin e bërë.

74. Në vijim të rezultateve të hetimit neni “Dh” i Aneksit të Kushtetutës në pikat 3 dhe 4 parashikon se:

“3. Nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të shpjegojë të kundërtën.

4. Nëse subjekti i deklarimit përpiqet të bëjë deklarime të pasakta, ose të fsheh kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të shpjegojë të kundërtën.”

75. Kështu në bazë të nenit 52, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me gjetjen e dërguar nga vëzhguesi ndërkombëtar, të pranuar nga trupi gjykues, si dhe rezultateve të hetimit, ju kalua subjektit të rivlerësimit barra e provës për të sqaruar lidhur me to. Subjekti i rivlerësimit u pyet a njihet ai me shtetasin A. I.

76. Në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kalimin e barrës se provës mbi këtë çështje të ngritur nga trupi gjykues ai shpjegon:

“Të Nderuar Anëtare të trupit gjykues,

Për të provuar vërtetësinë e deklarimeve të mia nga ana juaj mund të bëhet edhe një hetim i tërthortë dhe të ballafaqohen të dhënat edhe për bashkëshorten time, e cila ka punuar për periudhën tetor 2003 - nëntor 2011 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

Në qoftë se unë do të kem pasur mundësi për të ndikuar në pozitën e shtetasve A. Sh dhe A. I., këtë do ta kisha bërë më së miri nëpërmjet personit më të afërt që unë kam, bashkëshortes sime. Siç rezulton nga konkluzionet e hetimit paraprak për vlerësimin e figurës prej jush, ky fakt tejet i rëndësishëm ka kaluar pa u vënë re.

Në bazë të provave të shqyrtuara prej trupit gjykues gjatë procesit të rivlerësimit kam konstatuar se ndaj shtetasit A. I., ka disa procese gjyqësore penale të zhvilluara në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Është fare e lehtë të verifikohet si nga raporti i DSIK-së për subjektin e

rivlerësimit, bashkëshorten R. S, të dhënat e institucioneve ligjzbatuese, si dhe nga verifikimi i proceseve gjyqësore që ajo ka zhvilluar për periudhën 2003 - 2011, se në asnjë rast të vetëm ju nuk do të gjeni asnjë informacion, dhe asnjë vendim penal apo civil ku të jenë përfshirë shtetasit A. Sh ose A. I..

Ndihma dhe lidhja me persona të papërshtatshëm fillon së pari me ofrimin e mundësive që ka bashkëshortja dhe unë në shmangien në mënyrë të kundërligjshme nga përgjegjësia penale apo favore civile, sesa hipoteza për të ndikuar tek kolegë të tjerë. Në morinë e të gjithë atyre gjyqtarëve që kanë gjykuar çështjet e shtetasit A. I. në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier nuk ndodhet emri i bashkëshortes sime. Gjykoj se po ta kishte në dispozicion vëzhguesi ndërkombëtar këtë të dhënë shumë të rëndësishme, si dhe kjo të ishte bërë objekt hetimi, konkluzioni do të ishte i ndryshëm dhe nuk do të më ishte ngarkuar barra e provës.

Në vazhdim të gjetjeve se unë kam ndikuar në vendimet e marra për mos ekstraditim e shtetasit A. I., mendoj se këto gjetje nuk i përgjigjet të vërtetës.

Rezultati i procesit të mosekstradimit nuk ka ardhur për shkak të ndikimit tim personal për shkak të detyrës, por ndryshimi i rrethanave të procedimit ndaj këtij shtetasi në shtetin italian. Pra është vendosur nga një element tërësisht jashtë çdo ndikimit tim, për shkak të zbutjes së qenësishme të akuzave penale si dhe mungesës së autoritetit kërkues, shteti Italian.

Siç provohet nga vendimi ***, datë 22.04.2014, të Gjykatës së Shkallës së Parë Torino Itali me vendim gjyqësor të formës së prerë, shtetasi A. I., është shfajësuar nga akuza më e rëndë, ajo e pjesëmarrjes në organizatë kriminale. Ky fakt është cilësuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier dhe Gjykata e Apelit Vlorë të cilat në mënyrë të pavarur kanë analizuar këtë rrethanë dhe së bashku me vlerësimin e rrethanave të tjera si: mosinteresimi i autoritetit kërkues, në përfundim kanë vendosur rrëzimin e kërkesës për ekstraditim.

Pasi mora provat pranë institucionit tuaj, më datë 10.07.2018, konstatoj se në gjithë ecurinë e tij procesi i ekstradimit të shtetasit A. I., ka kaluar në gjyqtarë të disa rretheve gjyqësore dhe niveleve, po ashtu edhe në Gjykatën e Lartë. Siç konstatohet me lehtësi është një numër shumë i madh gjyqtarësh, çka të shpie në konkluzionin logjik se unë nuk kam mundësi dhe as pushtet që për një çështje ku përfshihen edhe autoritete të huaja të ndërhyrjet prej meje.

Dua të sqaroj se pasi studiova materialet gjyqësore të procesit të ekstradimit, konstatohet se të gjitha vendimet gjyqësore kanë të njëjtin qëndrim ligjor, çka vërteton se kontrolli gjyqësor është bërë në disa nivele dhe rezultati ka qenë gjithmonë i njëjtë.

Për sa i përket pjesëmarrjes sime në vendimin për masën e sigurimit unë nuk kam pasur ndonjë konflikt interesi sipas kodit të procedurës penale, si dhe jo vetëm në atë rast, por në asnjë rast nuk kam lehtësuar pozitën e të gjykuarit A. I., qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë. Në gjetje përmenden disa burimeve konfidenciale të cilat pretendohen se kanë prova, por që nuk më janë vënë në dispozicion nga ana e Komisionit. Ashtu siç e kam përmendur në email-et datë 9 dhe 10 korrik kam kërkuar që në respektim të procesit të rregullt ligjor sipas nenit 6 të KEDNJ-së dhe Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ballafaqohem jo vetëm me faktet në ngarkimin tim, por edhe me prova, qofshin këto edhe të dhëna nga burime sekret. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka autoritetin kushtetues t'u kërkojë organeve ligjzbatuese që edhe në rastin e të dhënave të cilat mbrohen nga sekreti shtetëror të deklasifikohen dhe të përdoren kundër meje në një proces publik. Çdo gjetje, çdo dukje përbën një konkluzion i cili duhet të bazohet në fakte dhe në prova. Duke mos më bërë me dije faktin konkret, se si dhe ku e kam ushtruar ndikimin e paligjshëm më është cenuar parimi i procesit të rregullt ligjor, në bazë të nenit 6 të KEDNJ-së, aq më tepër kur më është ngarkuar edhe barra e provës.

Jam i gatshëm që procesi i rivlerësimit të zhvillohet me dyer të mbyllura në rast se këto të dhëna janë të një shkalle të tillë që cenojnë sigurinë kombëtare. Unë kam të drejtën që të njihem me të gjitha indicet, provat në ngarkimin tim dhe burimet nga janë marrë, në kushtet kur unë kam barrën e provës, kontradiktoriteti është pothuajse i pamundur.

Kjo kërkesë është akoma më e rëndësishme kur vlerësimi im zhvillohet vetëm për një komponent, atë të figurës.”

76.1 Subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues të administrojë provat plotësuese si pjesë e dokumentacionit:

1. Vendim nr. ***, datë 26.03.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier që i përket shtetasit A. I.
2. Vendim nr. ***, datë 22.04.2014, i Gjykatës së Torino-s, Itali, që i përket shtetasit A. I.
3. Vërtetim page, datë 09.07.2018, nga shoqëria “***”.
4. Vërtetim page, datë 09.07.2018, nga Drejtoria Arsimore Rajonale e Qarkut Fier.
5. Letërmirësjellje datë 09.08.2018, nga Njësia Administrative , nr. **, Bashkia Fier
6. Çertifikata familjare datë 09.07.2018.
7. Çertifikata dhe raport mjekësor.

77. Subjekti i rivlerësimit nuk i është përgjigjur pyetjes a njihet ai me shtetasin A. I. Në shpjegimet e tij ai nuk ka sqaruar nëse ka pasur ndonjë kontakt apo komunikim jo rastësor mes tyre.

78. Po ashtu vendimi i përmendur nr. ***, datë 22.04.2014, i Gjykatës së Torino-s, Itali, që i përket shtetasit A. I., i paraqitur edhe nga subjekti i rivlerësimit, e ka shfaqësuar atë vetëm nga akuza më e rëndë, ajo e pjesëmarrjes në organizatë kriminale, por ka mbetur akuza e trafikimit të lëndës narkotike e llojit kokainë, çka e bën këtë person të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të nenit 3, pika 15, të ligjit nr. 84.2016.

79. Sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit si dhe provat e paraqitura, nuk provuan pavërtetësinë e informacionit të përcjellë në gjetjen e paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar.

80. Subjekti i rivlerësimit, kërkoi që ti viheshin në dispozicion paraprakisht dhe ti bëhen publike në seancë dëgjimore, rezultatet e hetimit të thelluar edhe për komponentin e pasurisë dhe atë profesional.

80.1 Kjo kërkesë nuk u pranua nga trupi gjykues, pasi rezultatet e hetimit për komponentin e figurës arrinin në përfundimin se provat kanë nivelin e provueshmërisë sipas ligjit nr. 84/2016 dhe se subjekti i rivlerësimit me shpjegimet dhe provat e paraqitura nuk arriti të provojë të kundërtën.

80.2 Në procesin e rivlerësimit për subjektin Shkëlzen Selimi, trupi gjykues vendosi për vlerësimin përfundimtar të tij bazuar vetëm në kriterin e figurës.

80.3 Për shmangien e çdo keqinterpretimi, marrja e vendimit mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për z. Shkëlzen Selimi, vetëm mbi kriterin e kontrollit të figurës, nuk përbën në asnjë rast gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të vlerësimit profesional.

81. Verifikimi i pastërtisë së figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi, u mbështet në: (1) identifikimin e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës; (2) verifikimi nëse ka tendenca kriminale për përfshirje në krimin e organizuar; (3) vlerësimin e përgjithshëm nëse individit mund të vihet nën presion nga strukturat kriminale; dhe (4) vërtetësinë e deklaratimit në deklaratën për figurën.

82. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ai

është përpjekur të bëjë deklaratime të pasakta dhe të fsheh kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

83. Në zbatim të pikës 3 dhe 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës ndaj tij zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit, dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. Subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën me shpjegimet dhe provat e paraqitura prej tij dhe të bindë trupin gjykues mbi pavërtetësinë e rezultateve të hetimit.

84. Në përfundim të procesit të verifikimit të figurës për subjektin e rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi, arrihet në përfundimin se raporti i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar rezulton i vërtetë.

85. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës, në mënyrë të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin, duke fshehur se ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

86. Subjekti i rivlerësimit ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, mbështetur në standardet e kontrollit të figurës të përcaktuara në nenin 38 të ligjit nr.84/2016.

87. Ndaj tij ngrihen dyshime të arsyeshme se ai mund të vihet lehtësisht nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar.

88. Disponohen të dhëna nga ku ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave që ushtrojnë funksione publike.

89. Disa fakte dhe prova të cilat janë administruar në dosje, përbëjnë sekret shtetëror të mbrojtur nga ligji për sekretin shtetëror dhe nuk mund të bëhen publike. Mos zbulimi i informacionit të klasifikuar, nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër, gjatë një procesit gjyqësor, apo në procedurat administrative, nuk përbën në vetvete një shkelje të së drejtave themelore të personit, ky është një konsensus i gjithëpranuar¹⁰.

90. Përfundimet e nxjerra nuk i referohen këtij informacioni specifik, por konkluzioneve të nxjerra nga rezultatet e hetimit administrativ, gjykimit të fakteve relevante të paraqitura në dosje dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit.

V. KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, zhvilloi seancën dëgjimore publike, ku subjekti i rivlerësimit vendosi të mos qëndrojë për të dëgjuar dhe dhënë shpjegime, lidhur me rezultatet e hetimit, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti nuk ka arritur nivel të besueshëm të kontrollit të figurës.

¹⁰ Shih vendimin e GjEDNJ, "Çështja Regner, kundër Republikës Çeke".

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe në bazë të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës, nenit 4 pika 2, 58, pika 1, germa “c” si dhe të nenit 61, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlzen Selimi, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Lartë Tiranë.
2. Ky vendim i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 30.07.2018, ora 9:30.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda Çiftja
Kryesues

Valbona Sanxhaktari
Relator

Xhensila Pine
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Anisa DUKA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Vendimi nr. 5
i Trupës Gjyquese nr. 4
Korrigjim vendimi nr. 52 datë 30.07.2018

Sot në datë 17.09.2018, Trupa gjyquese nr. 4 e përbërë nga:

Etleda Çiftja	(Kryesuese)
Valbona Sanxhaktari	(Relator)
Xhensila Pine	(Anëtar)

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

- 1. Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përlllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
- 2. Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

U mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatores se çështjes znj. Valbona Sanxhaktari për korrigjimin e një gabimi material në vendimin e subjektit të rivlerësimit z. Shkëlzen Selimi.

Në faqen numër 23 të vendimit nr. 52, datë 30.07.2018, në Kreun V “Konkluzione përfundimtare”, paragrafi i dytë “Për këto arsye,” togëfjalëshi “si dhe të nenit 61, pika 3, të ligjit nr.84/2016” të zëvendësohet me togëfjalëshin “si dhe të nenit 61, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr.84/2016”.

Trupa pasi vendosi se kërkesa e relatores qëndron konstatoi se pjesa tjetër e vendimit është e saktë dhe mbetet e pandryshueshme, sepse vendimi i argumentuar është bazuar në nenin 61 pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 84/2016.

V E N D O S I:

- 1. Në faqen numër 23 të vendimit nr. 52, datë 30.07.2018, në Kreun V “Konkluzione përfundimtare”, paragrafi i dytë “Për këto arsye,” togëfjalëshi “si dhe të nenit 61, pika*



- 3, të ligjit nr.84/2016” të zëvendësohet me togfjalëshin “si dhe të nenit 61, pikat 2 dhe 3, të ligjit nr.84/2016”.
2. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korrigjim.
 3. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
 4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Trupa Gjyquese Nr.04

Etleda Çiftja

Valbona Sanxhaktari

Xhensila Pine

Sekretare gjyqësore

Anisa Duka

Kryesuese

Relatore

Anëtare

